



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor
- * Trajnimi i Trajnuesve

Qershor 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Vizita e Këshillit të Studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina“

Me 02 qershor 2022, Akademia e Drejtësisë ka pritur në vizitë Këshillin e Studentëve të Fakultetit Juridik “Hasan Prishtina” të Universitetit të Prishtinës .

Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi për së afërmi i studentëve me veprimtarinë e Akademisë.

Me rastin e vizitës studentët u njoftuan me aktivitetet e AD-së, sukseset dhe sfidat e saj. Në vijim studentët diskutuan për impaktin që kanë

materialet ligjore dhe literatura e AD-së në procesin e formësimit të tyre si juristë. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe bashkëpunimit në të ardhmen sidomos me programet praktike për studentë.

Në vizitë ishin gjithësejt 15 studentë që kryesisht ishin në vitin e parë dhe të dytë të studimeve.



Akademia e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës pjesë e Mbledhjes së 38-të Plenare të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) në Maltë



Me 27 – 28 qershor 2022 – Me ftesë nga Sekretariati i CEPEJ i Këshillit të Evropës, delegacioni nga Kosova i përbërë nga Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) Albert Zogaj morën pjesë në mbledhjen e tridhjetë e tetë (38) Plenare të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) e cila u mbajt në Valetta, Maltë.

Në këtë mbledhje, diskutohej rreth temës “Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të një drejtësie të dixhitalizuar”, sfidave të drejtësisë dixhitale si dhe mënyrat për të përgatitur më mirë gjyqtarët për valën e ndryshimeve.

Mes tjerash u diskutua lidhur me zhvillimet në drejtësinë kibernetike dhe inteligjencën artificiale, punët në fushën e cilësisë së drejtësisë, menaxhimin e kohës gjyqësore si dhe programet e bashkëpunimit dhe zhvillimet e fundit

në fushën e drejtësisë në shtetet anëtare dhe vëzhguese.

Gjatë vizitës, Drejtori Ekzekutiv i AD-së z. Fejzullahu dhe Kryesuesi i KGJK-së z. Zogaj realizuan një numër takimesh me zyrtarë të lartë nga KE, fillimisht me Presidentin e CEPEJ z. Ramin Ramin Garagurbanli, Zëvendës Presidentin, z. Francesco Depasquale, Sekretaren e CEPEJ, znj. Muriel Decot si dhe Zëvendës Sekretaren e CEPEJ, znj. Clemence Bouquemont, për të vazhduar me takime me Ambasadorin Christian Meughly Përfaqësues i Përhershëm i Zvicrës në Këshillin e Evropës dhe Kryesuesi i Grupit Raportues - Bashkëpunimi Ligjor i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës; Znj. Oognah Buckley Zëvendës Sekretare e Përgjithshme nga Departamenti i Drejtësisë së Irlandës dhe njëherë Përfaqësuese e Presidencës së Irlandës në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës;

Gjatë kësaj vizite, delegacioni i përbërë nga Drejtori i Akademisë së Drejtësisë dhe Kryesuesi i KGJK-së Zogaj vlerësuan lartë bashkëpunimin e vazhdueshëm me Këshillin e Evropës përmes projekteve të cilat kanë për qëllim forcimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor në Kosovë.



Forumi Rajonal “Konventa e Gjykimeve të HCCH 2019: Perspektivat për Ballkanin Perëndimor - Programi i Forumit Rajonal 2022

Me 30.06-01.07.2022 u mbajte Forumi Rajonal në Shkup të Maqedonisë së Veriut me temën boshte: “Konventa e Gjykimeve të HCCH 2019: Perspektivat për Ballkanin Perëndimor - Programi i Forumit Rajonal 2022. Ky Forum u organizua në bashkë-organizim me “Projektin për Forcimin e Zbatimit të Ballkanit (BESP)” i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Hollandeze dhe zbatuar nga Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC) dhe projektin “Reforma Ligjore për Zhvillimin Ekonomik në Ballkanin Perëndimor” financuar nga Ministria Federale Gjermane për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (BMZ) dhe zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH) dhe Unionin Ndërkombëtar të Oficerëve Gjyqësor (UIHJ).

Qëllimi i këtij Forumi ishte që nëpërmjet shkëmbimit të përvojave mes zyrtarëve nga rajoni të avancohen njohuritë e zbatuesve të ligjit, lidhur me Konventën e vitit 2019 “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare” (Konventa e HCCH-së e vitit 2019 “Për vendimet gjyqësore”) e cila do të nxisë forcimin e bashkëpunimit gjyqësor në njohjen dhe ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare, si dhe do të garantojë një siguri ligjore në marrëdhëniet tregtare ndërmjet shteteve. Harmonizimi dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve në çështjet civile dhe tregtare

mes sistemeve gjyqësore në vendet e Evropës Juglindore, do t'i bëjë procedurat më pak komplekse dhe më pak të gjata, por edhe do të redukojë dukshëm shpenzimet financiare.

Në këtë Forum morën pjesë përfaqësues nga rajoni (Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia nga radhët e zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, Fakulteteve Juridike, OJQ-ve si dhe organizmave të Përmbauesve Privat në shtetet përkatëse). Pjesëmarrës në këtë konference ishin edhe grupi i zyrtarëve nga Republika e Kosovës në përbërje të të cilit ishin: një eksperte e Projektit Ndërkombëtar Ligjor, një zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, kryetari i Odës së Përmbauesve Privat të Kosovës dhe një trajnues gjyqësor nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Forumi ishte i strukturuar në gjashtë sesione tematike me kontribute nga akterë të ndryshëm:

Hyrje e përgjithshme: bashkëpunimi ndërkufitar në civil dhe çështjet tregtare dhe forcimin e zbatimit në Ballkanin Perëndimor - Me kontribute të përfaqësuesve të CILC dhe GIZ-it.

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare: kombëtare dhe perspektivat rajonale - Me kontribute të Ministrive të Drejtësisë.

Perspektivat për Ballkanin Perëndimor: gjykimet e HCCH 2019 – Marrëveshja - Moderator: Z. Jos Uitdehaag. Me kontributet nga Dr. Ning Zhao (HCCH) dhe Juristët-Kampionët Kombëtarë.

Trajnimi gjyqësor dhe specializimi i aftësive: riekzaminim - qasja në Ballkanin Perëndimor - me kontribute nga KBR, Dhomat e Agjentëve të Përmbarrimit dhe Akademitë gjyqësore. Në këtë sesion u prezantua një vështrim i shkurtër mbi aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë në këtë tematikë dhe synimet e saja programore për të ardhmen.

Zbatimi ndërkufitar i vendimeve gjyqësore të huaja në Ballkanin Perëndimor dhe roli i agjentëve përmbarrues: teoria përballë praktikës - Me kontribute nga UIHJ dhe Dhomat e Agjentëve të Përmbarrimit.

Rruga përpara: njohja dhe zbatimi ndërkufitar

në Ballkanin Perëndimor dhe udhërrëfyesi drejt ratifikimit të HCCH 2019.

Gjithashtu në fund u diskutua për rrugën përpara: njohja dhe zbatimi ndërkufitar në Ballkanin Perëndimor dhe udhërrëfyesi drejt ratifikimit të Konventës-HCCH 2019. Të gjithë pjesëmarrësit ishin aktiv dhe mundësuan me kontributet e tyre shkëmbim e debat mbi perspektivat dhe përfitimet e Konventës së Gjykimeve të HCCH 2019 dhe perspektivat për Ballkanin Perëndimor.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Gjatë muajit qershor aktivitetet e këtij programi kanë vazhduar në përgatitjet paraprake për programin trajnues për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj të cilët pritet së shpejti të dekretohen pasi janë përfunduar gjitha fazat e rekrutimit nga KGJK dhe KPK.

Në kuadër të këtyre përgatitjeve ka filluar hartimi i moduleve trajnuese dhe përditësimi i tyre

përshtatshmërisht me legjislacionin aktual në fuqi.

Në mbështetje të Programit për Hulumtime dhe Publikime, modulet përkatëse janë dërguar për shtyp në kompaninë kontraktuese të AD-së për të siguruar ekzemplarët për përfituesit e Programit të Trajnimit Fillestare.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Liria e shprehjes-Shpifja dhe mbrojtja e reputacionit dhe siguria e gazetarëve

Më 01-02 Qershor 2022, në bashkëpunim me Projektin e Bashkimit Evropian JUFREX për regionin e Pejës është realizuar “Trajnimi tematik në fushën e shpifjes, mbrojtjes së reputacionit dhe sigurisë së gazetarëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte të rris kapacitetet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në hetimin dhe mbrojtjen gjyqësore në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut, përkatësisht lirisë së shprehjes e cila është e garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe me Kushtetutën e Kosovës.

Trajnimi për dy ditë me radhë ka trajtuar aspekte të rëndësishme të lirisë së shprehjes me fokus te në rastet më të njohura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe në rastet vendore.

Në ditën e parë trajnimi është fokusuar në nocionet kryesore të lirisë së shprehjes; Shpifja dhe mbrojtja e reputacionit sipas legjislacionit vendor dhe sipas standardeve të GJEDNJ-së si dhe në rolin e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës

Në ditën e dytë trajnimi është fokusuar në sig-

urinë e gazetarëve-kornizën ligjore vendore dhe rastet gjyqësore, sigurinë fizike dhe ligjore të gazetarëve, regjistrimi dhe dokumentimi i kërcënimeve ndaj gazetarëve, standardet e GJEDNJ-së për sigurinë e gazetarëve dhe dokumentimi i tyre në platforma ndërkombëtare.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe punës në grupe të vogla të një rasti konkret, dallimi në mes të fakteve dhe opinioneve si dhe prezantimit të buletineve të përgatitur nga JUFREX me raste nga e drejta e lirisë së shprehjes që përfaqësonin zhvillimet e fundit në GJEDNJ me lirinë e shprehjes.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 1 gjyqtarë, 3 prokurorë, 4 zyrtarë ligjor, 1 zyrtarë për informim dhe monitorim të mediave si dhe 2 zyrtarë policor (hetues dhe të komunikimit) dhe 5 avokatë nga regjioni i Pejës.



Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i Organizuar – Sesioni II

Më 07-08 Qershor 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i Organizuar – Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte të rrisë kapacitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe akterëve tjerë relevantë për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive rasteve të krimit të organizuar dhe zgjidhjen e tyre përmes vendimeve meritore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në teknikat e veçanta hetimore të krimit të organizuar, në mënyrat e vlerësimit të provave në rastet e krimit të organizuar me theks të veçantë të hetimeve financiare, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të drejtat e viktimave tek krimi i organizuar si dhe strategjitë e prokurorisë për hetimin e grupeve kriminale.

Trajnimi në ditën e dytë u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme siq janë: sekuestrimi

i corpora delictit të krimit të organizuar, sekuestrimi i benefiteve të përfituara nga krimi i organizuar, korniza strategjike dhe institucionale në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale.

Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë e studimit të një rasti praktik dhe gjithashtu pas secilës çështje që ishte objekt i trajtimit mundësinë e pyetjeve dhe debateve, paraqitjen e pikëpamjeve nga këndvështrimi i tyre dhe njëkohësisht shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në zgjidhjen e këtyre rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 5 gjyqtarë (1 nga Gjykata Supreme dhe 4 nga Gjykatat Themelore) 5 prokuror kryesisht nga niveli themelor, 5 ekspert nga Prokuroria Speciale si dhe 4 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykatat dhe Prokuroritë.



Trajnim tematik në fushën e shpifjes dhe mbrojtjes së reputacionit

Më 09-10 Qershor 2022, në bashkëpunim me Projektin e Bashkimit Evropian JUFREX është vazhduar me trajnimin dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve me temë: “Trajnim tematik në fushën e shpifjes dhe mbrojtjes së reputacionit”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte të rris kapacitetet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në hetimin dhe mbrojtjen gjyqësore në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut, përkatësisht lirisë së shprehjes e cila është e garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe me Kushtetutën e Kosovës.

Trajnimi për dy ditë me radhë ka trajtuar aspekte të rëndësishme të lirisë së shprehjes me fokus te në rastet më të njohura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe në rastet vendore.

Në ditën e parë trajnimi është fokusuar në nocionet kryesore të lirisë së shprehjes dhe parimet kryesore; Mbrojtja dhe reputacioni në nivel vendor: legjislacioni dhe zhvillimet e fundit në rastet të cilat përfshijnë mediat dhe

gazetarët, Jurisprudenca e GJEDNJ-së në mbrojtjen e reputacionit të figurave publike: kriteret dhe praktiket e fundit gjyqësore.

Në ditën e dytë trajnimi është fokusuar në praktikën gjyqësore vendore për mbrojtjen e reputacionit dhe standardet e përcaktuara: raste nga gjykatat themelore, Standardet e GJEDNJ: të drejtat dhe përgjegjësitë e gazetarëve dhe e drejta e përgjigjes, Roli i Këshillit i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur për Media në lidhje me rastet e shpifjes dhe mbrojtjen e reputacionit.

Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë e studimit të rasteve praktike dhe gjithashtu pas secilës çështje që ishte objekt i trajtimit mundësinë e pyetjeve dhe debateve, paraqitjen e pikëpamjeve nga këndvështrimi i tyre dhe njëkohësisht shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në zgjidhjen e këtyre rasteve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe punës në grupe të vogla të një rasti konkret, dallimi në mes të fakteve dhe opinioneve si dhe prezantimit të buletineve të përgatitur nga JUFREX me raste nga e drejta e lirisë së shprehjes që përfaqësonin zhvillimet e fundit në GJEDNJ me lirinë e shprehjes.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 34 gjyqtarë (3 nga Gjykata Supreme, 4 nga Gjykata e Apelit si dhe 24 nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës)

Trajnimi: Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve

Më 09-10 Qershor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi në formë të kombinuar me pjesëmarrje fizike dhe online me temë “Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve dhe zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi për vendosjen meritorë të rasteve përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi është fokusuar në trajtimin e aspektit material të ngacmimit seksual ndaj të miturve, dhunimit dhe në vijim aspekte të rëndësishme të procedimeve penale si ekzaminimit të fëmijut si palë e dëmtuar apo dëshmitarë, pedagogu dhe sqarimet e duhura sa i përket ndihmës së psikologut, pedagogut ose të një profesionisti tjetër gjatë procedurës.

Në ditën e dytë është folur për Konventën Lanzarote e cila është një hap i madh përpara në parandalimin e krimeve seksuale kundër fëmijëve, ndjekjen e kriminelëve dhe mbrojtjen e viktimave fëmijë. Fokusi i kësaj konvente sipas interpretimeve ishte në respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe sigurimin e mirëqenies së tyre.

Në fund pjesëmarrësit patën mundësinë e studimit të një rasti praktik i cili mundësoi e diskutimin dhe shkëmbimin e perspektivave mes pjesëmarrësve për rastin konkret.

Përfitues të kësaj tryeze ishin 5 gjyqtarë, 4 prokurorë kryesisht të nivelit themelor nga departamenti për të mitur dhe departamenti i përgjithshëm si dhe 5 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtar ligjor të gjykatave dhe prokurorive.



Program i Specializuar i Trajnimit Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni II

Më 14-15 Qershor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjin rasteve përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në trajtimin e elementeve të veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare me fokus te dashja si element i veprës penale, çështjet e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfitimit, qëllimit si element për vërtetimin e veprës penale të korrupsionit, vlerësimit të provave bindëse, të drejtpërdrejta dhe rrethanore, krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethanore, mashtrimit në prokurim si vepër e ndërlikuar, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua në trajtimin e konfliktit të interesit, marrjes së ryshfetit, dhënies së ryshfetit, nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore dhe veprave penale të këtij kapitulli. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe vlerësimit të provave qoftë të drejtpërdrejta dhe rrethanore, krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethanore si dhe keperdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar si dhe pasojave të rrezikshmërisë së këtyre veprave.

Pas përfundimit për secilën nga këto çështje u ofruan raste nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë duke krahasuar dhe shkëmbyer përvojat dhe praktikatat të cilat ishin të dobishme për secilin nga pjesëmarrësit që vendosin lëndët përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 13 gjyqtarë, 6 prokurorë si dhe një bashkëpunëtorë profesional kryesisht nga niveli themelor, departamenti për krime të rënda, special dhe departamenti i përgjithshëm.



Trajnim: Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik

Me 16 Qershor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik”.

Qëllimi i këtij trajnimi është që gjyqtarët dhe prokurorët të rrisin kapacitetet e tyre që në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjet në fuqi të zgjidhin rastet e veprave penale të nxitjes së urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit në baza të veçorive kombëtare, racore, fetare ose etnike.

Trajnimi si fillim u fokusua në trajtimin e aspektit material duke ofruar kuptimin dhe elementet e veprës penale të nxitjes së urrejtjes përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, veprës penale të ndërlidhur me

krimet e urrejtjes, të drejtat e viktimave të krimeve të urrejtjes gjatë procedurës penale, mbrojtja, asistimi dhe kompensimi i viktimave të krimeve të urrejtjes si dhe përforsimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes akterëve kyç.

Gjithashtu pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të rasteve nga praktika gjyqësore në vend rajon dhe Evropë të cilat mundësuan krahasimin dhe identifikimin e praktikave më të mira në zgjidhjen e rasteve përkatëse.

Pjesëmarrës në këtë trajnim janë 4 gjyqtarë (3 nga niveli themelor dhe 1 nga Apeli) si dhe 5 prokuror, kryesisht të nivelit themelor.



Tryezë: Liria e Shprehjes dhe mediave-Regjioni Prizren dhe Gjakovë

Më 21-22 Qershor 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e Bashkimit Evropian JUFREX në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme kanë realizuar ttryezën me temë “Shpifja dhe mbrojtja e reputacionit dhe siguria e gazetarëve”.

Qëllimi i kësaj Tryeze ishte të rrisë kapacitetin e profesionistëve ligjor e në veçanti të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe Evropiane në fushën e lirisë së shprehjes.

Gjatë kësaj tryeze u trajtuan temat: Hyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe testi prej tre hapësh; Shpifja dhe mbrojtja e reputacionit (korniza ligjore vendore dhe rastet gjyqësore); Shpifja dhe mbrojtja e reputacionit (standartet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut); Roli i Këshillit i Mediave të Shkruara të Kosovës; Siguria e gazetarëve (korniza ligjore vendore dhe rastet gjyqësore); Siguria fizike dhe ligjore e gazetarëve; Regjistrimi dhe dokumentimi i kërcënimeve ndaj gazetarëve;

Standardet e GJEDNJ-së për sigurinë e gazetarëve dhe dokumentimi i tyre në platformat ndërkombëtare; zbatimi i standardeve ndërkombëtare në praktikë; Prezantimi i Buletineve 1, 2 dhe 3 “Zhvillimet e fundit në GJEDNJ lidhur me lirinë e shprehjes”.

Prezantimet e detajuara mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe vendimet e ndryshme të gjykatave vendase të përpunuara nga një kombinim i eksperteve vendas dhe ndërkombëtar nxiten diskutime midis të gjithë pjesëmarrësve. U diskutuan gjithashtu edhe padit SLAPP si dhe u argumentuan me disa raste studimore specifike duke vënë në pah zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 17 pjesëmarrës, prej tyre 3 gjyqtarë, 2 prokurorë, 5 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive si dhe 3 avokatë dhe 3 zyrtarë policor nga regjioni i Prizrenit dhe Gjakovës.



Program i Specializuar i Trajnimit - Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi – Sesioni II

Më 22-23 Qershor 2021, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar Trajnimi Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi-Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zgjidhjen meritorë të rasteve në gjykatë. Gjithashtu gjyqtarët dhe prokurorët të jenë të informuar në lidhje me marrëveshjet e reja bilaterale në këtë fushë, por edhe për risitë që lidhen me krimet dhe format e reja të bashkëpunimit në përgjithësi.

Trajnimi për dy ditë me radhë u fokusua në trajtimin e kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare që përfshin hetimet, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat e të pandehurit të akuzuar për vepra terroriste, si dhe viktimat, përkatësisht viktimizimin nga terrorizmi.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar teknikave të hetimit dhe të provuarit e terrorizmit, lirive dhe të drejtave themelore të njeriut të rrezikuara nga masat represive kundër terrorizmit, kornizës strategjike dhe institucionale në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale kundër terrorizmit, viktimave të

terrorizmit dhe qasjes në drejtësi nga perspektiva e viktimave.

Po ashtu u trajtuan edhe aspekte tjera si të miturit kryes të veprave penale të ekstremizmit radikalizmit dhe terrorizmit, demonstrimi i teknikave të hetimit dhe të provuarit të terrorizmit, me theks të veçantë për liritë dhe të drejtat e njeriut, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbrojtjen e viktimave.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për rastet nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë duke trajtuar aspekte të rëndësishme qoftë materiale ashtu edhe procedurale të cilat shërbyen për një pasqyrë më të qartë të kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare kundër terrorizmit dhe për zbatimin e drejtë të ligjit lidhur me sanksionet penale ndaj kryerësit të veprave penale të terrorizmit.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 4 gjyqtarë (1 nga Apeli dhe 3 nga niveli themelor), 1 prokuror nga niveli themelor, 2 ekspert dhe 1 zyrtarë ligjor nga Prokuroria Speciale, 3 zyrtarë nga Shërbimi Sprovues si dhe 2 zyrtarë policor nga Policia e Kosovës.



Tryezë e rrumbullakët për çështje nga gjyqësia administrative”

Me 23 dhe 24 qershor 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoi dhe mbajti tryezën e rrumbullakët dyditore me temën boshte: “Tryezë për çështje nga gjyqësia administrative”, në të cilën u trajtuan çështjet aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.



Panelistë në këtë tryezë ishin: z. Enver Peci, kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Nebojsa Boricic dhe z. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme, znj. Luljeta Maxhuni dhe z. Ramush Bardiqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ dhe z. Islam Sllamniku, trajnues gjyqësor i përhershëm në AD-së .

Në ditën e parë të tryezës u trajtuan dilemat që janë paraqitur në praktikë lidhur me shqyrtimin e padisë dhe mundësia e evitimit të tyre në praktikën gjyqësore të departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Procedura lidhur me propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ dhe shqyrtimi i dilemave që janë paraqitur në praktikën gjyqësore të departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit si dhe aktet dhe dëshmitë e reja në konfliktin administrativ. Në ditën e dytë janë trajtuar çështjet që janë paraqitur në praktikë lidhur me detyrueshmërinë e aktgjykimit; Procedura sipas mjeteve juridike të rregullta në konfliktin administrativ me praktikën aktuale të Gjykatës së Apelit; Mjetet juridike të jashtëzakonshme në praktikën aktuale të Gjykatës Supreme të Kosovës; dhe çështjet

kontestuese në procedurën e konfliktit administrativ me shqyrtime krahasuese në region. Gjithashtu në ditën e dytë janë trajtuar çështja e zbatimit të dispozitave të LKA-së dhe nevoja lidhur me harmonizimin e ligjeve materiale të veçanta me LKA-në dhe rekomandime për plotësim-ndryshimet e dispozitave të LKA-së.

Fokusi i kësaj tryeze ishte edhe harmonizimi i praktikës gjyqësore në mes këtyre tre instancave gjyqësore kur vendosin lëndë nga lëmia e gjyqësisë administrative. Në këtë tryezë pjesëmarrësit këmbyen edhe përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore dhe dilemat që janë paraqitur në praktikë gjatë zbatimit të dispozitave të LKA-së.

Në tryezë u shqyrtuan edhe çështjet aktuale në lidhje me konfliktet administrative në praktikën gjyqësore në këtë lëmi si dhe zbatimi i drejtë i procedurave. Gjithashtu pjesëmarrësit patën rastin të njihen me praktiken gjyqësore aktuale të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe qëndrimet parimore të saj si dhe unifikimin e qëndrimeve lidhur me zbatimin e dispozitave të LKA-së.

Në këtë tryezë çështjet e ngritura dhe dilemat u trajtuan përmes shpjegimit të trajnuesve-pane listëve, duke pas në fokus ato që janë paraqitur në praktikë. Përmes shpjegimeve dhe pas diskutimeve të gjëra u nxjerrën edhe rekomandime lidhur me çështjet e ngritura në tryezë. Tryeza ishte koncipuar në atë mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit përmes diskutimeve të tyre kontribuan në suksesin e saj.

Përfitues në këtë tryezë ishin 5 gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës si dhe 6 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor dhe këshilltar të gjykatave nga të gjitha nivelet.

Trajnim: Aplikimi i Kodit Doganor dhe i akcizave të Kosovës

Më 28 Qershor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Aplikimi i Kodit Doganor dhe i akcizave të Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës për zgjidhjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve në praktikën gjyqësore.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik të KDAK-së të përcaktuara me këto ligje si dhe UA. Në vazhdim u diskutua për kodet tarifore dhe dokumentet e detyrueshme doganore për vlerësimin e drejtë të kodit tarifor duke u mbështetur në dokumentacionet përcjellëse që duhet t'i bashkëngjiten Deklaratës Doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë.

Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë të njihen për së afërmi me praktiken dhe qëndrimet e gjykatës në lidhje me rastet të cilat i trajton dhe i vendos gjykata, përfshirë vendosjes se vlerësimit dhe kodifikimit të mallit si dhe përcaktimin e tatimit në pronë. Gjithashtu u njohën me institucionet e zbatimit të legjislacionit në fushën doganore dhe

tatimore në Kosove, si dhe instrumentet dhe mekanizmat e inkasimit të hyrave për Buxhetin e Kosovës.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe metodave të vlerësimit të mallit importues, metodave të vlerësimit të shpenzimeve të transportit duke analizuar Udhëzimin Administrativ përkatës dhe përcaktimi i kodeve tarifore. Po ashtu, janë zbërthyer edhe dispozitat ligjore që përmban Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës dhe udhëzimet administrative përcjellëse për zbatimin e tij.

Një diskutim i rëndësishëm është zhvilluar edhe rreth trajtimit të çështjes së importeve të përkohshme.

Më pas janë diskutuar dhe komentuar disa raste studimi nga praktika e gjykatave vendore lidhur me situata të caktuara e për të cilat lidhen me situatat të cilat paraqiten në Gjykatë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 5 pjesëmarrës, prej tyre 1 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 3 bashkëpunëtorë profesional kryesisht të nivelit themelor të gjykatave.



Program i Specializuar i Trajnimit Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurimin Publik - Sesioni II

Më 29-30 Qershor 2021, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnimin e Vazhdueshëm (PTV) ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurimin Publik - Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth procedurave të prokurimit publik dhe skemat e mashtrimit dhe korrupsionit në këtë fushë për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve në gjykatë.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të prokurimit publik duke filluar nga planifikimi i prokurimit, inicimi i prokurimit, dosja e tenderit, specifikimet teknike, parimet kryesore dhe procedurat e prokurimit dhe dosjen e tenderit si dhe funksionet kryesore të institucioneve në fushën e prokurimit.

Në ditën e dytë trajnimi u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të mashtrimit dhe

korrupsionit në prokurimin publik duke filluar nga përkufizimi i mashtrimit dhe korrupsionit në prokurimin publik, skemat mashtruese dhe të korrupsionit në fazat e prokurimit, analizën e procesit të planifikimit, përgjegjësitë e komisionit vlerësues, zgjedhja e kontraktorit dhe dhënia e çmimit, procesi i ankesave dhe përgjegjësi në menaxhimin e kontratës, indikatorët e korrupsionit dhe mashtrimit që lidhen me prokurimin publik, plani për hetimin e veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik si dhe zbulimin e konfliktit të interesit.

Pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit të rasteve nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë dhe në këtë mënyrë të identifikojnë praktikatat më të mira në hetimin dhe zgjidhjen e rasteve përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 5 gjyqtarë, 2 prokuror, 3 zyrtarë policor, si dhe 5 bashkëpunëtorë profesional kryesisht nga niveli themelor i gjykatave dhe prokurorive.



Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor

Trajnimi: Zbatimi i Ligjit të Punës në kontestet e punës

Më 23 qershor 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ në kuadër të aktiviteteve për profesionistët e tjerë ligjor ka realizuar trajnimin de4dikuar zyrtarëve të ndihmës juridike falas me temë: “Zbatimi i ligjit të punës në kontestet e punës”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që zyrtarët e ndihmës juridike falas të avancojnë njohuritë dhe rrisin kapacitetet e tyre për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive kërkesave të qytetarëve në rastet e kontesteve të punës dhe të përmirësojnë shërbimet e tyre në përputhje me Ligjin për ndihmën juridike falas dhe Ligjin e punës.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të Ligjit të punës duke i kushtuar vëmendje të veçantë bazës ligjore sa i përket kontratave, llojeve të tyre, shkaqeve të shkëputjes së marrëdhënieve të punës si dhe procedurat para ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit. Po ashtu gjatë

këtij trajnimi është diskutuar edhe lidhur me mbrojtjen e të drejtave për të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit dhe mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë dhe vendimet e gjykatës në rastet kur konstatohet paligjshmëria e ndërprerjes së kontratës së punës.

Me rastin e këtij trajnimi pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit interaktiv me trajnuesit dhe shkëmbimin e përvojave dhe njëkohësisht në adresimin e problemeve praktike që atyre i’u shfaqen gjatë trajtimit të rasteve nga kontestet e punës në praktikë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 9 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regionet dhe 2 gjyqtarë dhe një bashkëpunëtorë profesional kryesisht nga niveli themelor i gjykatave.



Trajnim: Praktika dhe vendimet e GJEDNJ-së

Më 24 qershor 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ në kuadër të trajnimeve për profesionistët e tjerë ligjor ka realizuar trajnimin dedikuar zyrtarëve të ndihmës juridike falas me temë “Praktika dhe vendimet e GJEDNJ-së”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që zyrtarët e ndihmës juridike falas të avancojnë njohuritë dhe rrisin kapacitetet e tyre sa i përket Konventës Evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive kërkesave të qytetarëve në rastet e cenimit të drejtave të tyre me theks të drejtës në pronë.

Trajnimi u fokusua në konceptet themelore mbi të cilat bazohet Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ndërkaq vëmendje e veçantë kishte protokoli

shtojcë i kësaj konvente, përkatësisht neni 1 i këtij protokoli i cili ka të bëjë me mbrojtjen e pronës. Pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit edhe të praktikave dhe vendimeve të GJEDNJ-së sa i përket mbrojtjes së pronës. Gjithashtu janë diskutuar çështjet tjera si respektimi i jetës private dhe familjare (neni 8 i Konventës).

Përfitues në këtë trajnim ishin 17 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjione, si dhe 1 gjyqtare nga Gjykata themelore në Gjilan.



Aktivitetet për trajnues

Trajnim i Trajnuesve rreth përforcimit të luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në Familje

Me 8-10 qershor 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, projekti “Reinforcing the Fight Against Violence against Women and Domestic Violence – Phase III”, ka realizuar Trajnimin e Trajnuesve për bashkëpunëtorët profesional me temë: “Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në Familje”.

Qëllimi i trajnimit ishte që përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve të krijohet edhe një grup i caktuar i bashkëpunëtorëve profesional, si trajnues potencial në fushën e Dhunës ndaj grave/dhunës në familje, të cilët do ju asistojnë trajnuesve nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimet e ardhshme.

I tërë trajnimi është zhvilluar mbi bazën e manualit për trajnues, të përgatitur paraprakisht nga ekspertët Ariana Qosaj Mustafa dhe Eileen Skinneder.

Gjatë trajnimit janë trajtuar korniza ligjore




vendore dhe ndërkombëtare rreth dhunës në familje, Konventa e Stambollit, stereotipet e ndryshme gjinore, kuptimi i familjes si tërësi si dhe aspekte të rëndësishme procedurale në zgjidhjen e rasteve përkatëse.

I gjithë trajnimi është zhvilluar edhe me raste praktike dhe video simuluese të përzgjedhura nga 2 trajnuesit vendor: z. Faton Ademi – Gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe znj. Ariana Qosaj Mustafa – eksperte vendore duke mundësuar ofrimin e praktikave më të mira në këtë fushë.




Përfitues të trajnimit ishin 6 bashkëpunëtorë profesional nga gjykatat kryesisht nga niveli themelor 8 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga prokuroritë të cilit vinin nga radhët e nivelit themelor, të Apelit dhe Speciale, 2 Mbrojtës të viktimave dhe 1 Menaxher nga Zyra për Mbrojtje të viktimave, 2 zyrtarë policor si dhe 1 zyrtarë nga Agjencia për barazi gjinore.



Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660